

**ENTI RREGULLATOR I UJIT**



## **SHOQËRIA RAJONALE UK BERAT**

**ANALIZA E HUMBJEVE TË UJIT PËR VITIN 2022**

**Tiranë, 2023**

## **Bilanci i Ujit**

### **Analiza e Humbjeve të Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Berat**

#### **I. Te Përgjithshme mbi Hartimin e Bilancit të Ujit**

ERRU harton çdo vit Raportin e Bilancit të Ujit për shoqëritë që operojnë në Sektorin Ujësjiellës - Kanalizime. Ky raport merr një rëndësi të veçantë për një menaxhim racional të sektorit sepse trajton në mënyrë të veçantë treguesin e Ujit Pa të Ardhura, pra humbjet e ujit. Treguesi UPA lidhet ngushtësisht më cilësinë e shërbimeve që shoqëritë i ofrojnë konsumatorëve si edhe më qëndrueshmërinë financiare të tyre.

Organizimi i ri i shoqërive, në 15 shoqëri rajonale në sektorin UK, ka sjellë nevojën për një strukturim të ri të analizës mbi UPA dhe "Bilancin e Ujit" në tërësi. Analiza e humbjeve të ujit për çdo shoqëri rajonale kryhet duke analizuar fillimisht Bilancin e Ujit më vete për çdo njësi (ish shoqëri UK) përbërëse të saj dhe më tej analiza behet në mënyrë të integruar për shoqërinë rajonale në tërësi. Kjo qasje mundëson vënien në pah të problematikave individuale të çdo njësie të cilat duhet të kihen parasysh në të ardhmen për zgjidhjen apo përmirësimin e tyre.

Kjo analizë i vjen në ndihmë çdo shoqëri rajonale duke i mundësuar asaj që nëpërmjet analizës së komponentëve përbërës të Bilancit të Ujit, për çdo njësi dhe në tërësinë e shoqërisë rajonale, të njihet në mënyrë analitike me nivelin e humbjeve (UPA), të nën komponentëve të saj, arsyet e veçanta të nivelit të lartë të humbjeve të ujit, nevojën dhe mënyrën e monitorimit të humbjeve, problematikave e faturimit më matje dhe aforfe, si dhe rekomandimet që ERRU jep për çdo shoqëri UK për të realizuar përmirësimet e nevojshme në punën e tyre.

"Bilanci i Ujit" si një instrument mjaft i rëndësishëm në përmirësimin e treguesit kryesor të performancës UPA, duhet të hartohet më të dhëna sa më të sakta pasi hapat që do të ndërmerren për reduktimin e tij lidhen ngushtësisht edhe më qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë. Si model i hartimit të Bilancit të Ujit do të përdoret ai i IWA (Shoqërisë Ndërkombëtare të Shoqërive të Ujësjiellësve).

Duke patur parasysh gjendjen teknike të sistemeve të furnizimit më ujë si mungesën e matësve në burim, mos organizim të rrjeteve shpërndarëse bazuar në konceptin e Zonave më Matje të Pavarura (DMA-të), mangësitë në mjetet dhe metodat e monitorimit të konsumit, është vendosur që si metodologji e llogaritjes së nën komponentëve të Bilancit të Ujit të përdoret ajo nga "lart-poshtë" (top-down), ku fokusi kryesor në llogaritjen e humbjeve totale është përcaktimi i humbjeve të dukshme, dhe më tej përcaktohen ato reale.

#### **II. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Berat**

Shoqëria rajonale UK Berat u krijua nga bashkimi i ish shoqërive UK ose Njësitë, përkatësisht UK Berat – Kuçovë, UK Ura Vajgurore (Dimal), UK Poliçan dhe UK Skrapar.

Të dhëna të përgjithshme në lidhje me popullsinë e shërbyer, konsumin për banor me matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit të Sh. R UK Berat jepen në **tabelën 1**.

Nga të dhënat e Tabelës 1, probleme të nën faturimit me matje u konstatua për ish shoqërinë Skrapar (71.2 l/ditë për banor) e cila duhet të kryejë verifikimet mbi lidhjet dyfishe në rrjetet e furnizimit sidomos e zonat rurale. Probleme me faturimin aforfe rezultuan në të gjitha njësitë e Sh. R Berat. Njësitë Berat -Kuçovë dhe Ura Vajgurore(Dimal) duhet të analizojnë arsyet e mbi faturimit aforfe (nëse përfshijnë në të dhe klientët jo aktivë), sepse dihet që konsumi mesatar për banor për këtë lloj faturimi referuar VKM nr.102, datë 16.03.1992 duhet të jetë 150 litra/banor në ditë. Referuar po këtij vendimi, ish shoqëritë UK Berat Kuçovë dhe Dimal duhet të analizojnë me kujdes të dhënat mbi volumet faturuara dhe numrin e klientëve të faturuar aforfe, për të gjetur dhe arsyet e këtij mbi faturimi.

**Tabela Nr. 1** Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe

Shoqëria Rajonale UK Berat	Popullsia* e Shërbyer	Konsumi Total (në m3)	Konsumi i Matur (në m3)	Konsumi Pamatur (në m3)	Lidhjet me matës	Lidhjet pa matës	Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
							(l/ditë, banor)		
Berat Kuçovë	50,630	2,567,000	2,273,000	294,000	25,656	1,796	131.6	243.2	138.9
Ura Vajgurore (Dimal)	11,109	506,000	482,000	24,000	3969	151	123.4	161.5	124.8
Poliçan	5,916	200,000	144,000	56,000	1,951	598	87.1	110.5	92.6
Skrapar	9,053	321,900	67,700	254,200	1,051	2,603	71.2	108.0	97.4
<b>Shuma</b>	<b>76,708</b>	<b>3,594,900</b>	<b>2,966,700</b>	<b>628,200</b>	<b>32,627</b>	<b>5,148</b>	<b>122.7</b>	<b>164.6</b>	<b>128.4</b>

Referuar tendencës së rritjes së vazhdueshme të kërkesës për ujë, si dhe problematikat e pritshme të rezervave ujore për shkak të ndryshimeve klimatike duhet bërë një vlerësim i këtyre rezervave në krahasim me plotësimin e kërkesës për ujë, të paktën asaj aktuale. Për këtë qëllim në tabelën 2, krahas volumit të ujit të prodhuar dhe konsumit për popullsinë e shërbyer jepen dhe burimet ujore respektive dhe kapacitetet e tyre.

**Tabela 2** Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve

Shoqëria Rajonale UK Berat	Popullsia* e Shërbyer	Uji i Prodhuar që futet në sistem (në m3)	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe (l/ditë, banor)	Popullsia e Regjistruar në Zonën e Shërbimit	Burimet dhe Kapaciteti (000/m3/vit)	Sasia e Disponueshme e Ujit (l/ditë, banor)	Diferenca në Plotësimin e Kërkesës (l/ditë, banor)
Berat - Kuçovë	50,630	6,317,000	138.9	71,671	18,628	712.1	+573
Ura Vajgurore	11,109	1,228,000	124.8	21,412	2,952	377.7	+253
Poliçan	5,916	331,000	92.6	8,612	1,866	593.6	+501
Skrapar	9,053	768,000	97.4	9,736	77,000	21,667.9	+21,571
<b>UK Berat (Rajonale)</b>	<b>76,708</b>	<b>7,970,140</b>	<b>128.4</b>	<b>111,431</b>	<b>100,446</b>	<b>2,470</b>	<b>+2,341</b>

\* Popullsia në juridiksion u korrigjua duke u bazuar në të dhënat e INSTAT-it të publikuara në rang qarku në Janar të vitit 2023 ndërsa për popullsinë në shërbim si bazë përlogaritje shërbeu "mbulimi me shërbim" i raportuar nga vetë shoqëritë UK.

Nga tabela 2 shihet se **shoqëria rajonale UK Berat ka burime të mjaftueshme ujore për plotësimin e kërkesës për ujë në zonën e saj të shërbimit**. Në fokusin e shoqërisë rajonale duhet të jetë mbrojtja e burimeve nëpërmjet shfrytëzimit me efikasitet të burimeve ujore të disponueshme, duke u bazuar në prodhimin sipas kërkesës për ujë si dhe reduktimin e humbjeve ujit në të gjitha njësitë përbërëse për të arritur dhe qëllimin final "kohëzgjatje të furnizimit me ujë në 24/7" për çdo njësi furnizimi si dhe sigurimin e ujit për brezat e ardhshëm. **Sasia e disponueshme (e prodhuar) e ujit për Skraparin në vlerën prej rreth 21 m3/ditë për banor ose rreth 21,000 litra/ditë, banor duket absurde që të jetë e pranueshme dhe që kërkon verifikime të menjëhershme nga ana e shoqërisë për saktësimin e saj.**

## II.1 UPA për Ish Shoqërinë UK Berat – Kuçovë

Gjatë vitit 2022, ish shoqëria UK Berat-Kuçovë ka prodhuar 6,317,000 m<sup>3</sup> ujë prej cilës **vetëm 14% rezulton i matur**. Shërbimi me ujë ofrohet për rreth 71% të popullsisë në juridiksion, numri i lidhjeve për këtë shërbim raportohet 29,944 lidhje prej të cilave 27,986 lidhje janë të pajisur me ujëmatës ndërsa pjesa tjetër faturohen aforfe.

**“UPA” rezulton në nivelin 53.84%**. Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë nuk është i organizuar në zona të pavarura me matje (DMA), për rrjedhoje monitorimi i humbjeve nuk mund të bëhet i detajuar sipas DMA-ve, por në tërësi për të gjithë sistemin. Kjo gjendje vështirëson monitorimin efikas të humbjeve dhe njëkohësisht bëhet pengesë gjatë ndërtimit të strategjive për zvogëlimin e humbjeve me orientim prioriteti në DMA-të më problematike.

**Në tabelën 3** paraqitet bilanci i ujit si dhe komponentët përbërës të tij për ish shoqërinë UK Berat - Kuçovë.

**Tabela 3.** Bilancit i Ujit për Ish Shoqërinë Berat-Kuçovë- Viti 2022.

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m <sup>3</sup> )	Ndaj Ujit të Prodhuar (në%)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	6,317,000	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	2,587,000	40.95%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	329,000	5.21%
<b>Faturimi Total</b>	<b>2,916,000</b>	<b>46.16%</b>
<b>Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar</b>	<b>74,826</b>	<b>1.18%</b>
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	201,480	3.19%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	437,299	6.92%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	512,400	8.11%
<b>Humbjet e Dukshme (Administrative)</b>	<b>1,151,179</b>	<b>18.22%</b>
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	414,453	6.56%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	141,912	2.25%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit	264,153	4.18%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	1,345,970	21.31%
Humbjet e ujit nga riparimet ne linjat e sistemit të Ujësjellësit	8,507	0.13%
<b>Humbjet Reale (Teknike)</b>	<b>2,174,995</b>	<b>34.43%</b>
<b>Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)</b>	<b>3,326,174</b>	<b>52.65%</b>
<b>UJI PA TË ARDHURA</b>	<b>3,401,000</b>	<b>53.84%</b>

### Komente :

- UPA në nivelin 53,84% të prodhimit vjetor, konsiderohet në nivele mjaft të larta.
- Volumi i ujit të prodhuar raportohet i matur në nivelin (14%). Përqindja mjaft e ulët e prodhimit të matur si dhe pasaktësia e mundshme gjatë përlllogaritjes të sasisë së ujit të prodhuar me vlerësim (për 86% të totalit të ujit te prodhuar), mund të jetë shkak kryesor i diferencës mjaft të madhe ndërmjet volumit të ujit të prodhuar ndaj atij të faturuar.
- Niveli i humbjeve reale në rrjetin e transmetimit (6,56%), dhe veçanërisht në depot e ujit (4,18%) konsiderohet mjaft i lartë. Për këtë shoqëria duhet të verifikojë nëse ekzistojnë të regjistruara në evidenca të cilat vërtetojnë çarje mjaft të shpeshta të linjave të transmisionit, gjendje fizike të përkeqësuar të depove që rrjedhin etj.
- Numri i klientëve me ujëmatës përbën 93.4% të klientëve që përfitojnë këtë shërbim.

- Humbjet nga lidhjet e paligjshme në transmetim dhe shpërndarje në nivelin 10.11% të prodhimit vjetor konsiderohen mjaft të larta.

#### **Rekomandime:**

- *Në lidhje me përqindjen e lartë të mundshme të lidhjeve të paligjshme, Njësia duhet të ndër marrë plan veprimi për të përcaktuar sa me saktësisht bazën e klientëve, që krahas verifikimeve në terren (task forcë) të krahasohet edhe me bazën e klientëve të OSHEE-së, si edhe me verifikime në vend për anashkalim të ujëmatësimit me lidhje dytësore.*
- *Të thellohet në analizën për të përcaktuar se ku ekziston saktësisht problematika me ujë nën faturuar, si kontrolli i punës së lexuesve të matësive, a janë të pajisur me ujëmatës shtëpitë private dhe kryesisht në zonat rurale etj.*
- *Ti kushtohet kujdes dhe rëndësi e veçantë volumit të ujit të prodhuar që përcaktohet me vlerësim, për t'ju afruar sa më shumë realitetit deri sa të mundësohet prodhimi i matur në nivelin 100%.*
- *Për humbjet reale të larta në linjat e transmetimit dhe depot, nëse janë probleme evidente të gjendjes së keqe fizike të tyre, urgjentisht të planifikohen fonde nga qeveria qendrore ose me fondet e veta për riparimin e tyre.*
- *Shoqëria të shoh si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin më të mirë të humbjeve, për të diagnostikuar ku janë problemet më të mëdha me humbjet, në bazë të cilave do të hartohen planet e masave për zvogëlimin e tyre.*

#### **II.2 UPA për Ish Shoqërinë UK Ura Vajgurore (Dimal)**

Shërbimi i furnizimit me ujë në Njësinë Administrative Ura Vajgurore(Dimal) ofrohet për 52% të popullsisë në juridiksion. Prodhimi vjetor i vlerësuar raportohet 1,228,000 m3 ujë, **asnjë nga burimet e shfrytëzueshme nuk është i pajisur me aparat ujëmatës.**

Numri i lidhjeve me ujë raportohet 4473 lidhje ku 96% e tyre janë të pajisur me ujëmatës ndërsa pjesa tjetër faturohet aforfe.

Faturimi i realizuar rezulton në nivelin 46.01% të prodhimit.

**“Uji Pa të Ardhura” është në nivelin 52.02%.** Monitorimi i humbjeve në rrjetin shpërndarës nuk bëhet në bazë të DMA-ve.

**Në Tabelën 4** paraqiten komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për ish shoqërinë UK Ura Vajgurore.

**Tabela 4.** Bilanci i Ujit për Ish Shoqërinë UK Ura Vajguore (Dimal) – Viti 2022

Emërtimi	Viti 2022	Ndaj Ujit të Prodhuar (në%)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	1,228,000	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	541,000	44.06%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	24,000	1.95%
<b>Faturimi total</b>	<b>565,000</b>	<b>46.01%</b>
<b>Konsumi i autorizuar i pa faturuar</b>	<b>24,160</b>	<b>1.97%</b>
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	16,624	1.35%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	72,653	5.92%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	181,665	14.79%
<b>Humbjet e Dukshme (Administrative)</b>	<b>270,942</b>	<b>22.06%</b>
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	70,706	5.76%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	6,936	0.56%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit	36,394	2.96%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	217,121	17.68%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjellësit	12,581	1.02%
<b>Humbjet Reale të ujit (teknike)</b>	<b>343,738</b>	<b>27.99%</b>
<b>Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)</b>	<b>614,680</b>	<b>50.06%</b>
<b>UJI PA TË ARDHURA</b>	<b>638,840</b>	<b>52.02%</b>

**Komente :**

- UPA rezulton në nivele të pakënaqshme dhe përben 52.02% të prodhimit vjetor.
- Pasaktësia e mundshme gjatë përlllogaritjes të sasisë së ujit të prodhuar me vlerësim (për 100% i vlerësuar), mund të jetë shkak kryesor i diferencës mjaft të madhe ndërmjet volumit të ujit të prodhuar ndaj atij të faturuar.
- Humbjet e shaktuara nga Konsumi i Autorizuar i pa Faturuar janë 1.97% e prodhimit vjetor rezulton mbi normat e lejuara.
- Humbjet administrative në nivelin 22.06% të prodhimit shkaktohen kryesisht nga lidhjet e paligjshme në rrjetet e transmetimit(1.35%), shpërndarje(5.92%) si dhe nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim(14.79%). Këto humbje konsiderohen mjaft të larta dhe të papranueshme pasi kanë një impakt financiar negativ për shoqërinë.
- Humbjet teknike në nivelin 27.99%, rezultojnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës (25.66%) dhe atë të transmetimit(7.14%) dhe konsiderohen në kufijtë e niveleve të pa pranueshme. Shoqëria duhet të analizojë situatën në terren për mundësinë e uljes së tyre.

**Rekomandime:**

- *Duke patur parasysh që asnjë burim i shfrytëzueshëm nuk është i pajisur me ujëmatës, nevoja për investime në ujëmatës në prodhim është e domosdoshme dhe imediate. Shoqëria duhet të marrë masa urgjente për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa me real.*
- *Në lidhje me përqindjen e lartë të mundshme të lidhjeve të paligjshme, Njësia duhet të ndërmarrë plan veprimi për të përcaktuar sa më saktësisht bazën e klientëve, që krahas verifikimeve në terren (task-forcë) të krahasohet edhe me bazën e klientëve të OSHEE-së, si edhe me verifikime në vend për anashkalim të ujëmatësit me lidhje dytësorë.*

- Shoqëria të shoh si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin më të mirë të humbjeve, për të diagnostikuar ku janë problemet më të mëdha me humbjet, në bazë të cilave do të hartohen planet e masave për zvogëlimin e tyre.

### II.3 UPA për Ish Shoqërinë UK Poliçan

Shërbimi i furnizimit me ujë në Njësinë Administrative Poliçan ofrohet për 69% të popullsisë në juridiksion. Prodhimi vjetor raportohet i vlerësuar dhe në sasinë 331,000 m<sup>3</sup> ujë, **asnjë nga burimet e shfrytëzueshme nuk është i pajisur me aparat ujëmatës.**

Nga raportimi i të dhënave, faturimi total rezulton 68.32% e prodhimit, ndërsa **“Uji Pa të Ardhura” në nivelin 31.68%.**

Ish shoqëria UK Poliçan ka në administrim 2,836 lidhje me ujë, ku 78% e tyre faturohen me matje dhe pjesa e tjetër aforfe. Monitorimi i humbjeve në rrjetin shpërndarës nuk bëhet në bazë të DMA-ve.

**Në Tabelën 5** paraqiten komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për ish shoqërinë UK Poliçan.

**Tabela 5.** Bilanci i Ujit për Ish Shoqërinë UK Poliçan – Viti 2022

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m <sup>3</sup> )	Ndaj Ujit të Prodhuar (në%)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	331,000	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	173,900	52.54%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	52,250	15.79%
<b>Faturimi Total</b>	<b>226,150</b>	<b>68.32%</b>
<b>Konsumi i Autorizuar i Pa Faturuar</b>	<b>1,000</b>	<b>0.30%</b>
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	0	0.00%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	0	0.00%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	32,000	9.67%
<b>Humbjet e Dukshme (Administrative)</b>	<b>32,000</b>	<b>9.67%</b>
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	16,100	4.86%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	900	0.27%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit	900	0.27%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	52,950	16.00%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjetës	1,000	0.30%
<b>Humbjet Reale (Teknike)</b>	<b>71,850</b>	<b>21.71%</b>
<b>Humbjet Totale (Reale dhe të Dukshme)</b>	<b>103,850</b>	<b>31.37%</b>
<b>UJI PA TË ARDHURA</b>	<b>104,850</b>	<b>31.68%</b>

#### Komente :

- UPA rezulton në nivelin **31.68%** të prodhimit vjetor dhe përfaqëson si nivel një nga treguesit më të mirë në sektor. Gjithsesi, vërtetësia e nivelit të UPA duhet justifikuar duke verifikuar në terren të dhënat, sidomos për mungesën e lidhjeve të paligjshme që sjell si përfundim një nivel të humbjeve të dukshme prej 9,67% të prodhimit.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në zona të ndara me matje(DMA), formati është plotësuar me mjaft vështirësi kur kërkohet nga ERRU.
- Pasaktësia e mundshme në llogaritjen e sasisë së ujit të prodhuar 100% me vlerësim (jo me matje), vështirësitë në hartimin e bilancit të ujit, mungesa e DMA-ve etj, vë në dyshim vërtetësinë e vlerës absolute të volumit të ujit të prodhuar dhe njëkohësisht nivel të pabesueshëm të treguesit UPA.

- Humbjet teknike në nivelin 21.71% të prodhimit vjetor, ku 16% i përkasin rrjetit shpërndarës dhe 4,86% linjës së transmetimit, duken të jenë në nivele të pranueshme.
- Konsumi total faturohet me matje në nivelin 77% ndërsa 78% e konsumatorëve janë të pajisur me matës individuale duke përfaqësuar një nivel jo shumë të pranueshëm të matjes.

#### **Rekomandime:**

- *Duke patur parasysh që asnjë burim furnizimi me ujë nuk është i pajisur me ujëmatës nevoja për investime në ujëmatës në prodhim është e domosdoshme dhe imediate, shoqëria duhet të marrë masa urgjente për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre, në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.*
- *Shoqëria duhet të gjejë fonde për të rritur përqindjen e konsumatorëve familjare me matës që ky tregues të jetë sa më afër nivelit 100%, që të bëjë të mundur minimizimin e humbjeve të dukshme nga lidhjet e paligjshme. Ndonëse këto humbje raportohen nivelin 0% nga shoqëria, që siç u theksua dhe më sipër, është nivel i pabesueshëm bazuar dhe në shtrirjen gjeografike të rrjeteve të furnizimit që kërkon verifikime më të thelluara.*
- *Duke patur parasysh mangësitë dhe vështirësitë në raportimet e vlerave të Bilancit të Ujit që ka demonstruar stafi i shoqërisë, është i domosdoshëm trajnimi i stafit si dhe caktimi i një personi përgjegjës për monitorimin e humbjeve, saktësimin e të dhënave si dhe hartimin e bilancit të ujit për gjatë gjithë muajve të vitit.*
- *Shoqëria të shoh si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin më të mirë të humbjeve, për të diagnostikuar ku janë problemet më të mëdha me humbjet, në bazë të cilave do të hartohen planet e masave për zvogëlimin e tyre.*

#### **II.4 UPA për Ish Shoqërinë UK Skrapar**

Në Njësinë Administrative Skrapar shërbimi i furnizimit me ujë ofrohet për rreth 93% të popullsisë në juridiksion. Prodhimi vjetor i vlerësuar raportohet në sasinë 768,000 m<sup>3</sup> ujë.

**Treguesi i UPA rezulton në nivelin 53.26%** . Konsumi i Autorizuar i Faturuar raportohet në nivelin **46.74%** ndërsa Konsumi i Autorizuar i pa Faturuar në nivelin 4.95% e prodhimit, ndërkohë që Shoqëria duhet të konsumojë për nevojat e veta rreth 1% të ujit të prodhuar.

Numri total i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë raportohet 3,977 lidhje, nga të cilat rreth 1/3 e tyre faturohet me matje ndërsa pjesa tjetër aforfe. Lidhjet e paligjshme raportohen të pranishme vetëm në rrjetin e shpërndarjes.

**Në Tabelën 6** paraqitet Bilanci i Ujit dhe komponentët përbërës të tij për ish shoqërinë UK Skrapar.



**Tabela 6.** Bilanci i Ujit për Ish Shoqërinë UK Skrapar – Viti 2022

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m <sup>3</sup> )	Ndaj Ujit të Prodhuar (në%)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	768,000	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	135,000	17.58%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	224,000	29.17%
<b>Faturimi Total</b>	<b>359,000</b>	<b>46.74%</b>
<b>Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar</b>	<b>38,000</b>	<b>4.95%</b>
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	0	0.00%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	17,000	2.21%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	79,000	10.29%
<b>Humbjet e Dukshme (Administrative)</b>	<b>96,000</b>	<b>12.50%</b>
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	65,000	8.46%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	38,000	4.95%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit	47,000	6.12%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	121,000	15.76%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjellësit	4,000	0.52%
<b>Humbjet Reale (Teknike)</b>	<b>275,000</b>	<b>35.81%</b>
<b>Humbjet Totale (Reale dhe të Dukshme)</b>	<b>371,000</b>	<b>48.31%</b>
<b>UJI PA TË ARDHURA</b>	<b>409,000</b>	<b>53.26%</b>

**Komente :**

- UPA (53.26%) rezulton në nivel të lartë e të pakënaqshëm.
- Vetëm 33% e konsumatorëve familjare janë të pajisur me matës, si rezultat vetëm 38% e konsumit faturohen me matje.
- Prodhimi vjetor nuk matet, por përcaktohet me vlerësim duke bërë të pabesueshëm dhe nivelin e UPA në këtë njësi.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme ku mungojnë zonimi sipas DMA.
- “Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim” (4.95%), “Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit”(6.12%) si dhe Konsumi i Autorizuar i Pa Faturuar(4.95%) rezultojnë në nivelet mjaft të larta.
- Humbjet e dukshme nga lidhjet e paligjshme në transmetim(0%) dhe në shpërndarje(2%) duken jo të besueshme.
- Në Humbjet teknike (35.81%), humbjet e shkaktuara kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin e transmetimit (8.46%),“humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim” (4.95%), “humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit”(6.12%), konsiderohen mjaft të larta për të cilat duhen marrë masat për reduktimin e tyre sa më parë.
- Stafi gjithmonë ka paraqitur vështirësi për hartimin e bilancit të ujit si rrjedhim nevoja për trajnim mbi humbjet dhe menaxhimin e tyre është e domosdoshme.

**Rekomandime:**

- *Duke patur parasysh që asnjë burim furnizimi me ujë nuk është i pajisur me ujëmatës nevoja për investime në ujëmatës në prodhim është e domosdoshme dhe imediate, prandaj shoqëria duhet të marrë masa urgjente për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.*

- Shoqëria duhet të gjejë fonde për të rritur përqindjen e konsumatorëve familjarë me matës që ky tregues të jetë sa me afër nivelit 100%, për të mundësuar minimizimin e humbjeve të dukshme nga lidhjet e paligjshme. Ndonëse këto humbje raportohen në nivele mjaft të ulta, vlera të cilat duken të pabesueshme.
- Duke patur parasysh mangësitë dhe vështirësitë në raportimet e vlerave të Bilancit të ujit që ka demonstruar stafi i shoqërisë, është i domosdoshëm trajnimi i stafit si dhe caktimi i një personi përgjegjës për monitorimin e humbjeve, saktësimin e të dhënave si dhe hartimin e bilancit të ujit për gjatë gjithë muajve të vitit.
- Shoqëria të shoh si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin më të mirë të humbjeve, për të diagnostikuar ku janë problemet më të mëdha me humbjet, në bazë të të cilave do të hartohen planet e masave për zvogëlimin e tyre.

### III Përmbledhëse e UPA për Shoqërinë Rajonale UK Berat

**Shoqëria Rajonale UK Berat**, e krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK Berat-Kuçovë, Skrapar, Poliçan dhe Ura Vajguore ofron shërbimin e furnizimit me ujë vetëm për 76,708 banorë ose 69% të popullsisë totale. Numri i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë raportohet 41,381 lidhje, nga të cilat 32,854 lidhje janë të pajisur me aparate ujëmatës.

Prodhimi vjetor 7,970,140 m<sup>3</sup> rezulton i matur në nivelin 10%, nevoja për aparate ujëmatës në pikat prodhuese është imediate për të gjitha burimet e shfrytëzueshme. **Uji Pa të Ardhura është në nivelin 52.88%** të ujit që hyn në sistem pasi shoqëria faturon vetëm 3,756,400 m<sup>3</sup> ujë ose 47.13% të prodhimit.

**Tabela 7** paraqet komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për vitin 2022, për Sh. Rajonale UK Berat.

**Tabela 7. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Berat – Viti 2022**

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m <sup>3</sup> )	Ndaj Ujit të Prodhuar (në%)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	<b>7,970,140</b>	<b>100.00%</b>
Konsumi i ujit të faturuar i matur	3,138,883	39.38%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	617,517	7.75%
<b>Faturimi Total</b>	<b>3,756,400</b>	<b>47.13%</b>
<b>Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar</b>	<b>137,986</b>	<b>1.73%</b>
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	1,392,671	2.47%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	528,502	6.63%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	646,065	8.11%
<b>Humbjet e Dukshme (Administrative)</b>	<b>1,392,671</b>	<b>17.47%</b>
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	533,259	6.69%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	183,748	2.31%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit	331,447	4.16%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	1,615,041	20.26%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjetës	20,088	0.25%
<b>Humbjet Reale (Teknike)</b>	<b>2,683,583</b>	<b>33.67%</b>
<b>Humbjet Totale (Reale dhe të Dukshme)</b>	<b>4,076,254</b>	<b>51.14%</b>
<b>UJI PA TË ARDHURA</b>	<b>4,214,240</b>	<b>52.88%</b>

#### Komente :

- Treguesi UPA në nivelin 52.88% të prodhimit vjetor, megjithëse nën mesataren e sektorit për të gjithë vendin konsiderohet i lartë dhe që duhet përmirësuar.
- Niveli i matjes për faktorin “Uji i prodhuar” në nivelin 10%, bën të pa besueshme të gjitha vlerat absolute të vëllimeve të ujit që janë komponentë të bilancit të ujit. Në veçanti për njësinë Skrapar fakti që *sasia e disponueshme (e prodhuar) e ujit në vlerën prej rreth 21 m<sup>3</sup>/ditë për*

*banor ose rreth 21,000 litra/ditë, banor duket mëse absurde që të jetë e pranueshme dhe që kërkon verifikime të menjëhershme nga ana e shoqërisë për saktësimin e saj.*

- Humbjet nga lidhjet e paligjshme në rrjetin shpërndarës (6.63%) nuk konsiderohen të besueshme dhe duhen verifikuar në terren.
- Në humbjet teknike, niveli 6,69% i humbjeve nga rrjedhjet në linjat e transmetimit, konsiderohet mjaft i lartë prandaj duhet dhënë argumenta të mëtijshme për justifikimin e tyre.
- Konsumatorët familjarë me matje përbëjnë rreth 80% të numrit total të konsumatorëve, që për një menaxhim korrekt të kërkesës për ujë kërkohet të jetë sa më afër nivelit 100% të matjes.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në zona të ndara me matje (DMA) në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë.
- Në përgjithësi hasen mjaft vështirësi nga stafet për monitorimin e humbjeve dhe hartimin e bilancit të ujit në të gjithë zonën e shërbimit.

### **Rekomandime:**

- *Të bëhen përpjekje për sigurimin e fondeve për të projektuar dhe zbatuar sisteme DMA në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë që mundëson një monitorim, diagnostikim dhe marrjen e masave për uljen e humbjeve në sistemet e furnizimit me ujë, si dhe hartimin e një bilanci korrekt të ujit.*
- *Të trajnojë vazhdimisht stafin teknik në programet kombëtare të humbjeve të ujit të organizuara nga SHUKALB dhe me gjerë, si dhe të caktojë një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara, për hartimin e bilancit të ujit për çdo DMA dhe për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë rajonale.*
- *Duke patur parasysh që asnjë burim furnizimi me ujë nuk është i pajisur me ujëmatës, nevoja për investime në ujëmatës në prodhim është e domosdoshme dhe imediate, Shoqëria duhet të marrë masa urgjente për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.*
- *Shoqëria duhet të gjejë fonde për të rritur përqindjen e konsumatorëve familjare me matës që ky tregues të jetë sa më afër nivelit 100%, për të mundësuar një menaxhim racional të kërkesës për ujë, si dhe minimizimin e humbjeve të dukshme, pavarësisht se ato raportohen në disa raste mjaft të ulta dhe të pabesueshme.*
- *Hartimi i një plan veprimi me prioritet instalimin e matësave në shtëpitë private dhe kryesisht në zonat rurale.*
- *Në lidhje me përqindjen e lartë të mundshme të lidhjeve të paligjshme, shoqëria duhet të ndërmarrë plan veprimi për të përcaktuar sa më saktësisht bazën e klientëve bazuar edhe me bazën e klientëve të OSHEE-së.*
- *Të ngrihet një Task Forcë e cila vazhdimisht e në bashkëpunim me degën e shitjes, të jetë në veprim në terren me verifikime në vend për anashkalim të ujëmatësit me lidhje të dyta apo klientë të paregjistruar me kontratë me shoqërinë, si kontroll i punës së lexuesve të matësave dhe në përgjithësi për evidentimin e problematikës me ujin e nën faturuar.*
- *Të krijojë dhe të mirëmbajë të gjitha sistemet e informacionit, për të patur raportim të saktë dhe të besueshëm të të dhënave të kërkuara, në lidhje me bilancin e ujit dhe çdo informacioni tjetër që mund të kërkohet.*
- *Të planifikojë investime në ujëmatës për të gjithë kategoritë e konsumatorëve, për të patur konsum të matur për çdo lidhje uji që faturohet.*

- *Për çdo lidhje pa matës, në pamundësi për vendosjen e matësit, nëpërmjet faturuesve duhet të verifikohet numri i banorëve (certifikatë familjare) për çdo lidhje dhe më pas të faturohen sipas VKM nr.102, datë 16.03.1992.*
- *Problematika në disa raste nuk është e njëjtë për çdo njësi. Për këtë duhet ti referohet problematikës në bilancin përkatës të çdo Njësie të veçantë.*
- *Të rrisë bashkëpunimin me ERRU-në për tejkaluar vështirësitë në hartimin e bilancit të ujit dhe të dorëzojë atë në kohë pranë ERRU-së. Bilanci i ujit duhet të dorëzohet çdo 6 muaj, vërtetësia dhe saktësia e të dhënave të bilancit do të vlerësohet nga ERRU si penalitet ose bonus për shoqërinë raportuese.*